
VLERËSIMI I PËRPUTHSHMËRISË: PËRMBLEDHJE E REZULTATEVE

*Kurum International SH.A (IFC Project # 33378)
Shqipëri*

Ankesa 1

Kurum Holdings është një kompani turke që prodhon dhe tregon hekur, çelik, oksigjen dhe gëlqere. Në vitin 1999 Kurum Holdings krijoi Kurum International (“klienti”) për të shfrytëzuar një uzinë çeliku në Elbasan, Shqipëri.

Në Shtator 2013, IFC miratoi për klientin një hua 30 milionë euro nga llogaria e saj dhe deri në 66 milionë euro në bashkëhua. Qëllimi i investimit ishte të mbështeste blerjen dhe rehabilitimin nga klienti të katër hidrocentraleve (HEC) në Shqipëri. HEC-et u blenë për të siguruar energji elektrike më të lirë dhe më të qëndrueshme për aktivitetet e klientit në prodhim çeliku. Si pjesë e investimit, klientit ju kërkua të zbatonte standardet M&S të IFC në HEC-et e sapo blera. IFC gjithashtu kreu një vlerësim të shpejtë të rreziqeve mjedisore dhe sociale (M&S) që lidheshin me uzinën e çelikut dhe i kërkoi klientit të zbatonte disa masa të specifikuara për kontrollin e ndotjes në uzinën e çelikut. Megjithatë, IFC nuk kërkoi që uzina e çelikut e klientit të plotësonte standardet M&S të IFC në mënyrë më të përgjithshme.

Në Qershor 2015, CAO mori një ankesë nga anëtarë komuniteti cilët jetojnë afërsi të uzinës së çelikut të klientit në Shqipëri. Ankesa ngre problemet që lidhen me ndikimet shëndetësore nga ndotja e ajrit që supozohet të prodhohet nga uzina e çelikut. Ndërkohë që ankuesit e pranojnë që kompania ka bërë përmirësime, ata perceptojnë që shkarkimet nga uzina, veçanërisht natën, vazhdojnë të jenë të dëmshme. Për më tepër, ata deklarojnë që informacioni rreth ndotjes nga uzina e çelikut nuk është i disponueshëm.

Qëllimi i një vlerësimi të përputhshmërisë nga CAO është të sigurojë që hetimet e përputhshmërisë të fillojnë vetëm në lidhje me projekte që ngrenë shqetësime të rëndësishme në lidhje me përfundimet M&S dhe/ose çështje me rëndësi sistemike për IFC. Për të vendosur nëse do të fillojë apo jo një hetim, CAO peshon faktorë përfshirë shkallën e shqetësimeve të ngritura nga një ankesë, rezultatet e një shqyrtimi paraprak të performancës M&S të IFC në lidhje me këto çështje, dhe një vlerësim më të përgjithshëm nëse një hetim i përputhshmërisë do të ishte përgjigja e duhur.

Një pyetje kyç për këtë vlerësim të përputhshmërisë është nëse standardet M&S të IFC janë të zbatueshme për uzinën e çelikut të klientit. Kërkesat e IFC rreth fushës së veprimit të kërkesave të saj M&S janë të ndërlikuara. Në rastet kur një investim i IFC ka një gjurmë M&S të përcaktuar qartë, Politika e Qëndrueshmërisë mundëson që IFC të kufizojë zbatimin e kërkesave të saj M&S tek aktivitetet e biznesit që po financon. Në të njëjtën kohë, Standardi i Performancës 1 (PS1) i IFC kërkon një vlerësim të rreziqeve dhe ndikimeve M&S në kontekstin e një fushe ndikimi të

projektit, përfshirë impiantet e bashkëngjitura, ndikimet e tërthorta mbi shërbimet e ekosistemit, ndikimet që vijnë nga veprimet e palëve të treta dhe ndikimet e zinxhirit të furnizimit. Një vështirësi kryesore në përcaktimin e objektit të zbatimit të politikave të IFC është që PS1 ofron një përkufizim të gjerë të termit projekt, duke u shprehur që çdo përdorues duhet të specifikojë aktivitetet e biznesit për të cilat zbatohet Standardi i Performancës, duke përcaktuar në të njëjtën kohë që objekti i procesit të identifikimit të rreziqeve dhe ndikimeve M&S duhet të jetë në përputhje me praktikën e mirë ndërkombëtare për sektorin.

Kur merr në konsideratë nëse uzina e çelikut ishte pjesë e projektit, dokumentacioni i shqyrtimit të bërë nga IFC para investimit paraqet deklaratat kundërtënëse. Personeli i IFC fillimisht u tha drejtuesve që uzina e çelikut do të duhet të zbatojë Standardet e Performancës. Dokumentacioni i miratimit të investimit më vonë nuk është specifik nëse uzinës së çelikut do t'i kërkohej apo jo të zbatonte Standardet e Performancës të IFC. Ndërkohë që një deklaratë e qartë nga IFC që theksonte se uzina e çelikut ishte jashtë objektit të projektit ishte e përfshirë në dokumentacionin paraprak të miratimit, kjo u hoq nga versioni përfundimtar që ju paraqit Bordit të IFC. Megjithatë, marrëveshja e IFC për investimin kërkon zbatimin e Standardeve të Performancës të IFC vetëm tek hidrocentralet. Marrëveshja gjithashtu kërkon që klienti të zbatojë disa masa kontrolli të ndotjes në uzinën e çelikut. Gjatë këtij vlerësimi, IFC vuri re që këto masa ishin zhvilluar pas një vlerësimi të shpejtë të uzinës së çelikut për shkak të rreziqeve të reputacionit që lidhen me performancën së saj mjedisore.

Pas lëvrimit të huasë së IFC, IFC ka mbikëqyrur zbatimin e zërave të Planit të Veprimit M&S (ESAP) të miratuar që lidhet me uzinën e çelikut. Në Nëntor 2014, IFC konfirmoi që klienti kishte: (a) riparuar mbulesën e uzinës së çelikut; (b) instaluar sistem të monitorimit të vazhdueshëm të shkarkimit të pluhurit në sistemin e filtrimit në repartin e shkrires; dhe (c) instaluar një alarm të mosfunksionimit të filtrave të repartit të gëlqeres në uzinën e çelikut, në përputhje me ESAP. Megjithatë, meqenëse uzina nuk punonte në kohën e vizitës së IFC, IFC nuk ishte në gjendje të shqyrtonte efektivitetin e këtyre ndërhyrjeve si masa të kontrollit të ndotjes. Menjëherë pas kësaj kohe, klienti filloi procedurat e falimentimit. Gjatë kësaj periudhe, IFC nuk mori raportime të M&S nga klienti.

Shqetësimet e ankuesve në lidhje me ekspozimin ndaj ndotjes industriale përfaqëson një ndikim të mundshëm të rëndësishëm të aktiviteteve të klientit të IFC në prodhimin e çelikut, dhe faktet e disponueshme për CAO gjatë këtij vlerësimi të përputhshmërisë nuk arrin në përfundimin nëse këto ndikime po menaxhohen në përputhje me standardet e IFC: Megjithatë, ka një mungesë qartësie në lidhje me zbatueshmërinë e standardeve të IFC për kontrollin e ndotjes në rastin e impiantit të prodhimit të çelikut të klientit. Gjatë paraqitjes së këtij investimi në drejtuesit dhe Bordin e IFC, janë bërë nga IFC një seri deklaratash kundërshtuese dhe të paqarta në lidhje me zbatimin e kërkesave të saj M&S në rastin e uzinës së çelikut. Si rezultat nuk është e qartë që vendimi i IFC për të investuar ishte bërë në bazë të një të kuptuari të plotë të kuadrit të zbutjes së rreziqeve M&S për projektin.

Pas lëvrimit të kredisë, dokumentacioni i IFC demonstroi që IFC e ka mbikëqyrur zbatimin e masave të miratuara të kontrollit të ndotjes në uzinën e çelikut siç përfshihet në ESAP. Megjithatë, dokumentacioni i IFC mbi mbikëqyrjen nuk jep siguri që uzina e çelikut e klientit i plotëson standardet e IFC për kontrollin e ndotjes, angazhimin e palëve të interesuara apo trajtimin e ankesave. IFC i është shprehur CAO se, ndërkohë që nuk e konsideron uzinën e çelikut si pjesë e fushës së veprimit të projektit, mbikëqyrja e vazhdueshme e klientit nga IFC do të monitorojë efektivitetin e zbatimit të masave të kontrollit të ndotjes në uzinën e çelikut për të siguruar përputhje me standardet e IFC dhe udhëzimet e Bankës Botërore. Kjo do të bazohet në dëshirën e mirë të klientit meqenëse as standardet e IFC apo kërkesat standarde të raportimit M&S nuk ishin bërë pjesë e marrëveshjes së huasë për uzinën e çelikut. Për më tepër, IFC ju zotua CAO

që do të punojë me klientin e saj për ta inkurajuar të publikonte rregullisht të dhënat e shkarkimeve ndotëse tek komunitetet lokale pranë uzinës së çelikut.

Duke marrë parasysh masat e marra nga IFC dhe klienti i saj për të zbutur ndikimet negative të ndotjes të uzinës së çelikut të klientit, dhe mungesën e qartësisë mbi zbatimin e standardeve M&S të IFC në aktivitetet e klientit për prodhimin e çelikut, CAO arrin në përfundimin që një hetim mbi përputhshmërinë nuk është përgjigja e duhur për këtë ankesë. Si rezultat, ankesa mbyllet.

Rreth CAO

Misioni i CAO është të shërbejë si një mekanizëm ankimor i pavarur, i drejtë, i besuar, dhe efektiv dhe për të përmirësuar përgjegjshmërinë mjedisore dhe sociale të IFC dhe MIGA.

CAO (Zyra e Avokatit të Popullit Këshilltar për Pajtueshmërinë) është një post i pavarur që i raporton drejtpërdrejt Presidentit të Grupit të Bankës Botërore. CAO shqyrton ankesat nga komunitetet e prekura nga projektet e zhvillimit të ndërmarra nga të dy krahët e sektorit privat të Grupit të Bankës Botërore, Korporata Financiare Ndërkombëtare (IFC) dhe Agjencia për Garantimin e Investimeve Shumëpalëshe (MIGA).

Për më shumë informacion në lidhje me CAO, ju lutemi vizitoni www.cao-ombudsman.org

Përmbajtja

Shkurtime	6
I. Vështrim i Përgjithshëm i Procesit të Vlerësimit të Përputhshmërisë	7
II. Historiku	8
Investimi.....	8
Ankesa dhe Procesi i CAO për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve	8
III. Analiza	9
Kuadri Politikave të IFC.....	9
Vlerësimi Para-Investimor dhe Mbikëqyrja e IFC Analiza dhe Diskutimi.....	11
IV. Vendimi i CAO.....	13

Shkurtime

Shkurtimi	Përkufizimi
RVM	Raporti Vjetor i Monitorimit
CAO	Zyra e Avokatit të Popullit Këshilltar për Pajtueshmërinë (IFC dhe MIGA)
M&S	Mjedisor dhe Social
ESAP	Plani i Veprimit Mjedisor dhe Social
PSMS	Përmbledhja e Shqyrtimit Mjedisor dhe Social
IFC	Korporata Financiare Ndërkombëtare
KM	Kilometër
MIGA	Agjencia për Garancinë e Investimeve Shumëpalëshe
SP	Standardet e Performancës (IFC)
PII	<i>Përmbledhja e Informacionit mbi Investimin</i>

I. Vështrim i Përgjithshëm i Procesit të Vlerësimit të Përputhshmërisë

Kur CAO merr një ankesë për një projekt të IFC apo MIGA, ankesa referohet për vlerësim. Nëse CAO arrin në përfundimin që palët nuk janë të gatshme apo në gjendje të arrijnë një zgjidhje me ndërmjetësim, rasti i transferohet funksionit të CAO për përputhshmërinë për vlerësim dhe hetim të mundshëm.

Një vlerësim përputhshmërie gjithashtu mund të vihet në lëvizje nga zëvendës presidenti i CAO, drejtuesit e IFC/MIGA, apo presidenti i Grupit të Bankës Botërore.

Fokusi i funksionit të përputhshmërisë në CAO është IFC dhe MIGA, jo klienti i tyre. Kjo vlen për të gjithë aktivitetet, përfshirë sektorin real, tregjet financiare dhe këshillimin. CAO vlerëson se si IFC/MIGA janë siguruar rreth performancës së aktivitetit të biznesit apo këshillimi të tyre, si dhe nëse rezultatet e aktivitetit të biznesit apo këshillimit janë në përputhje me qëllimin e dispozitave përkatëse politike. Megjithatë, në shumë raste, në vlerësimin e performancës së një projekti dhe zbatimin nga IFC/MIGA të masave për të plotësuar kërkesat përkatëse, do të jetë e nevojshme që CAO të shqyrtojë veprimet e klientit dhe të verifikojë rezultatet në terren.

Me qëllim që të vendosë nëse kërkohet apo jo një hetim përputhshmërie, CAO fillimisht kryen një vlerësim përputhshmërie. Qëllimi i procesit të vlerësimit të përputhshmërisë është të sigurojë që hetimet e përputhshmërisë të fillojnë vetëm në lidhje me ato projekte që ngrenë shqetësime të rëndësishme në lidhje me përfundimet mjedisore dhe/ose sociale, dhe/ose çështje me rëndësi sistemike për IFC/MIGA.

Për të udhëhequr procesin e vlerësimit, CAO zbaton disa kritere bazë. Këto kritere provojnë vlerën e sipërmarrjes së një hetimi të përputhshmërisë, meqenëse CAO kërkon të përcaktojë nëse:

Ka prova të ndikimeve që mund të jenë shumë negative mjedisore dhe/ose sociale tani, apo në të ardhmen.

Ka tregues që një politikë apo kritere të tjera vlerësimi mund të mos jenë respektuar apo zbatuar siç duhet nga IFC/MIGA.

Ka prova që tregojnë se dispozitat e IFC/MIGA, të zbatuara apo jo, kanë dështuar në ofrimin e një niveli të duhur të mbrojtjes.

Gjatë kryerjes së vlerësimit, CAO angazhohet me ekipin e IFC/MIGA që punon me projektin specifik dhe palë të tjera të interesuara për të kuptuar se cilat kritere kanë përdorur IFC/MIGA për tu siguruar për performancën e projektit, se si janë siguruar IFC/MIGA rreth përputhjes me këto kritere, se si IFC/MIGA janë siguruar që këto dispozita kanë ofruar një nivel të përshtatshëm mbrojtjeje dhe, përgjithësisht, nëse një hetim përputhshmërie është përgjigja e përshtatshme. Pasi përfundon një vlerësim përputhshmërie, CAO mund të mbyllë çështjen apo të fillojë një hetim përputhshmërie të IFC ose MIGA.

Pasi CAO të përfundojë një vlerësim të përputhshmërisë, do të informojë me shkrim IFC/MIGA, Presidentin e Grupit të Bankës Botërore, dhe Bordin. Nëse një vlerësim i përputhshmërisë vjen nga një çështje e transferuar nga zgjidhja e mosmarrëveshjeve e CAO, ankuesi gjithashtu do të informohet me shkrim. Një përmbledhje e të gjithë rezultateve të vlerësimit do të bëhet publike. Nëse CAO vendos të fillojë një hetim përputhshmërie si një rezultat i vlerësimit të përputhshmërisë, CAO do të hartojë termat e referencës për hetimin e përputhshmërisë në linjë me Udhëzimet Operative të CAO.

II. Historiku

Investimi

Kurum Holdings është një kompani turke e themeluar në vitin 1975. Veprimtaria kryesore e saj është prodhimi dhe tregtimi i hekurit, çelikut, oksigjenit dhe gëlqeres. Kurum Holdings krijoi Kurum International ("klienti") në vitin 1999 me qëllim shfrytëzimin e një uzine çeliku në Elbasan, Shqipëri.¹

Në Shtator 2013, IFC miratoi për klientin një hua 30 milionë euro nga llogaria e saj dhe deri në 66 milionë euro në bashkëhuan. Qëllimi i investimit ishte të mbështeste blerjen dhe rehabilitimin nga klienti të katër hidrocentraleve në Shqipëri ("projekti"). Këto hidrocentrale, Ulëza, Shkopeti, Bistrica 1 dhe 2, kanë qenë në shfrytëzim që në vitet 60.

Synimi i klientit në blerjen e këtyre hidrocentraleve ishte të ulte kostot e energjisë elektrike në prodhimin e çelikut dhe të siguronte një burim të qëndrueshëm të energjisë elektrike për të vazhduar aktivitetet e tij pa ndërprerje të mëdha.²

Ankesa dhe Procesi i CAO për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve

Në Qershor 2015, CAO mori një ankesë nga disa banorë vendas të cilët jetojnë në afërsi të uzinës së çelikut të klientit në Elbasan.

Këndvështrimi i ankuesve

Shqetësimi kryesor i ankuesit lidhet me shkarkimet ndotëse në ajër nga uzina e çelikut. Ankuesit pranojnë që klienti ka bërë përmirësime në uzinë që nga blerja e saj në 1999. Megjithatë ata i perceptojnë shkarkimet nga uzina si të dëmshme për shëndetin dhe familjet e tyre që jetojnë në Katund i Ri dhe Bradashesh. Ata venë në dukje që shikojnë re ndotëse tymi, natën ose herët në mëngjes. Ata deklarojnë që ka pasur një rritje në problemet shëndetësore, dhe se kjo reflektohet në të dhënat e spitalit.

Ankuesit theksojnë se nuk kanë akses në informacion të disponueshëm, të kuptueshëm dhe të besueshëm mbi uzinën e çelikut dhe se si uzina e menaxhon ndotjen.

Ankuesit pranojnë rëndësinë ekonomike të uzinës së çelikut për zonën dhe se nuk po kërkojnë mbylljen e uzinës.³

Këndvështrimi i Kurum

Klienti vuri në dukje se kanë bërë një seri përmirësimesh në infrastrukturë dhe teknologji për të qenë në përputhje me standardet evropiane dhe të IFC-së për shkarkimet. Në mënyrë specifike, klienti vë re që ka instaluar filtra, ka investuar në impiantin e eliminimit të pluhurit dhe në mbajtjen e shufrave të nxehta ndërkohë që dërgohen në repartin e petëzimit, me synimin për të pakësuar shkarkimet. Klienti u shkreh që raporton rregullisht të dhënat mbi shkarkimet në qeverinë e Shqipërisë, huadhënësve të tyre dhe në mediat kryesore.⁴

Procesi i CAO për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve

¹ Kurum Holdings, 2012. *Raporti Vjetor 2011*. I disponueshëm në <https://goo.gl/C4RBs2>.

² IFC, 2013. *Përmbledhja e Informacionit mbi Investimin: Kurum*, e disponueshme në <https://goo.gl/qn73Qy>.

³ Raporti i Vlerësimit i CAO, Qershor 2015. I disponueshëm në <https://goo.gl/YLFe5W>.

⁴ Raporti i Vlerësimit i CAO, Qershor 2015.

Ankuesit dhe klienti ishin të hapur të angazhoheshin në një proces të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të lehtësuara nga CAO. Ky proces filloi në fund të vitit 2015. Një mbledhje e përbashkët u mbajt ndërmjet ankuesve dhe klientit në Dhjetor 2015, në të cilën u nënshkrua një Marrëveshje Kuadër për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve. Kjo marrëveshje përcakton rregullat bazë për procesin e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve. Prosesi i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve u pezullua nga Shkurt 2016 deri në Korrik 2017 meqenëse klienti ndaloi aktivitetin pasi hyri në procedura falimentimi. Në Shtator 2017, ankuesit vizituan uzinën e çelikut dhe vunë re se ishin bërë disa përmirësime që prej vizitave të mëparshme (veçanërisht në lidhje me efektivitetin e filtrit të pluhurit). Megjithatë, ankuesit besonin që kishte vend për përmirësime të mëtejshme dhe ata u shprehën që mbeten të shqetësuar rreth ndotjes së ajrit.⁵

Në Dhjetor 2017, tre anëtarë të komunitetit së bashku me klientin dhe një agjenci të monitorimit mjedisor, LENI-ING shpk, gjatë një vizite monitorimi të ndotjes në uzinën e çelikut. Gjatë këtij aktiviteti monitorimi, klienti shpjegoi teknologjinë e instaluar në vitin 2011 për të përmirësuar performancën e tij mjedisore. LENI-ING shpjegoi që ata kryejnë monitorim mujor të dioksidit të solfurit (SO₂), dioksidit të karbonit (CO₂), dioksidit të nitrogjenit (NO₂), the oksidit nitrik (NO_x), dhe me raporte tre-mujore që i dorëzohen rregullatorit kombëtar. Ankuesit ngritën pyetje në lidhje me procesin e përzgjedhjes të agjencisë së monitorimit mjedisor, pavarësinë e saj dhe bashkërendimin me procesin e monitorimit të zbatuar nga Agjencia Rajonale e Mjedisit. Ata gjithashtu bënë pyetje nëse matjet mund të bëheshin pranë shtëpive që janë afër uzinës, dhe jo vetëm brenda perimetrit të uzinës së çelikut.

Pas vizitës së monitorimit, ankuesit pranuan që klienti ka bërë përpjekje për të përmirësuar aktivitetet e tij, megjithatë ata vazhduan të ngrenë shqetësime të lidhura me ndikimet e supozuara të uzinës dhe gjetjet e monitorimit të LENI-ING shpk. Ankuesit kërkuan një proces të përbashkët monitorimi për të parë ndikimet mjedisore të klientit në zonën më të gjerë industriale. Klienti nuk ju përgjigj kësaj kërkesë. Si rezultat, procesi i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve përfundoi, dhe rasti u transferua te funksioni i përputhshmërisë i CAO në Korrik.⁶

III. Analiza

Ky vlerësim përputhshmërie fokusohet në shqyrtimin para investimit dhe mbikëqyrjen e investimit nga IFC në lidhje me çështjet e ngritura në ankesë. Në lidhje me zbatimin e standardeve të M & S të IFC në projekt, ngrihen çështjet e mëposhtme. (i) nëse IFC ka zbatuar siç duhet standardet e saj M&S në projekt, duke pasur parasysh kërkesat e Kuadrit të Qëndrueshmërisë dhe përfaqësimet e bëra gjatë miratimit nga ajo të projektit; dhe (ii) nëse IFC ka shqyrtuar dhe mbikëqyrur siç duhet investimin në lidhje me çështjet e ngritura në ankesë.

Kuadri Politikave të IFC

Investimi i IFC tek klienti është bërë në kontekstin e Politikës së Qëndrueshmërisë Mjedisore dhe Sociale të vitit 2012 (“Politika e Qëndrueshmërisë”) dhe Standardet e Performancës (PS), që së bashku ju referohen si Kuadri i Qëndrueshmërisë. Përmes Politikës së Qëndrueshmërisë, “IFC kërkon të të sigurojë, përmes shqyrtimit të duhur (due diligence), monitorimit, dhe supervizimit,

⁵ CAO, Nëntor 2017. *Raporti Progresiv i Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve*, i disponueshëm në <https://goo.gl/YLFe5W>.

⁶ CAO, Korrik 2018. *Raport Përmbyllës i Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve*, i disponueshëm në <https://goo.gl/YLFe5W>.

që aktivitetet e biznesit që financon janë zbatuar në përputhje me kërkesat e Standardeve të Performancës.”⁷

Shqyrtimi i duhur nga IFC’s (due diligence) merr në konsideratë rreziqet financiare, të reputacionit dhe M&S.⁸ Shqyrtimi i duhur M&S i IFC duhet të jetë në përputhje me natyrën shtrirjen dhe fazën e aktivitetit të biznesit, dhe me nivelin e rreziqeve dhe ndikimeve mjedisore.⁹ Në rastet kur IFC identifikon boshllëqe në përputhshmërinë e klientit me kërkesat e Standardeve të Performancës të IFC, IFC miraton një Plan Veprimi M&S (ESAP) me klientin si pjesë e investimit të IFC.¹⁰

Kërkesat M&S të IFC të lidhura me shqetësimet e ngritura nga ankuesit përfshijnë:

Standardi i Performancës 1, në mënyrë specifike kërkesat që lidhen me angazhimin e palëve të interesuara, publikimin e informacionit, trajtimin e ankesave dhe monitorimi i përputhshmërisë.

Standardi i Performancës 3, në mënyrë specifike kërkesat që lidhen me parandalimin e ndotjes dhe Udhëzimet Mjedisore, Shëndetësore dhe të Sigurisë të cilat përcaktojnë pragje specifike të shkarkimeve.

Në rastet kur IFC financon një aktivitet specifik biznesi me një gjurmë të qartë M&S, kërkesat M&S të IFC zbatohen për atë aktivitet specifik biznesi. Megjithatë, IFC inkurajon klientët e saj që të menaxhojnë rreziqet M&S në mënyrë sistematike në të gjitha veprimtaritë e tyre.¹¹ Pas investimit të IFC, IFC mbikëqyr klientin për të siguruar përputhshmërinë me kërkesat M&S të miratuara me klientin, përfshirë zërat specifikë në ESAP.¹²

IFC i kërkon klientëve të vlerësojnë rreziqet dhe ndikimet M&S në kontekstin e zonës së ndikimit të projektit.¹³ Siç përcaktohet në PS1 (parag. 8), zona e ndikimit përfshin: (i) projekti dhe aktivitetet dhe impiantet e klientit që janë të zotëruara, shfrytëzuara ose menaxhuara drejtpërdrejt dhe janë një përbërës i projektit; (ii) impiantet që lidhen me të;¹⁴ (iii) ndikimet e tërthorta të projektit mbi biodiversitetin apo mbi shërbimet e ekosistemit, dhe (iv) ndikimet e grumbulluara mbi zonat apo burimet e përdorura apo të ndikuara drejtpërdrejt nga projekti. Gjithashtu, në Procedurat e Shqyrtimit M&S (ESRP) të IFC përkufizimi i zonës së ndikimit përfshin referim në “impiantet e lidhura” që klienti ndërton ose kontrollon.¹⁵ Procesi i identifikimit të rreziqeve dhe ndikimeve duhet gjithashtu të marrë në konsideratë zinxhirët kryesorë të furnizimit të klientit.¹⁶

PS1 ofron një përkufizim të gjerë të termit projekt,¹⁷ duke u shprehur që çdo përdorues duhet të specifikojë aktivitetet e biznesit për të cilat zbatohet Standardi i Performancës,¹⁸ duke përcaktuar

⁷ IFC, 2012. Politika e Qëndrueshmërisë, para. 7.

⁸ IFC, 2012. Politika e Qëndrueshmërisë, para. 21.

⁹ IFC, 2012. Politika e Qëndrueshmërisë, para. 26.

¹⁰ IFC, 2012. Politika e Qëndrueshmërisë, para. 28.

¹¹ IFC, 2012. Politika e Qëndrueshmërisë, para. 29.

¹² IFC, 2012. Politika e Qëndrueshmërisë, para. 45. Procedurat e Shqyrtimit Mjedisor dhe Social 6 e IFC, Prill 2013.

¹³ IFC, 2012. Standardi i Performancës 1, parag. 8.

¹⁴ Impiantet e lidhura përkufizohen si impiante që nuk financohen si pjesë e projektit dhe që nuk do të ishin ndërtuar apo zgjeruar nëse projekti nuk do të ekzistonte dhe pa të cilat projekti nuk do të ishte i zbatueshëm.

¹⁵ IFC, ESRP 2013. Përkufizimet, të disponueshme në <http://bit.ly/2loWUEo>.

¹⁶ IFC, 2012. Politika e Qëndrueshmërisë, para. 10.

¹⁷ PS1 e përdor termin ‘projekt’ për t’ju referuar një grupi të përcaktuar aktivitetesh të biznesit, ku elemente fizikë, aspekte dhe impiante specifike që kanë mundësi të prodhojnë rreziqe dhe ndikime, duhet ende të identifikohen (para. 4).

¹⁸ IFC, 2012. Standardi i Performancës 1, shënimi 7.

në të njëjtën kohë që objekti i procesit të identifikimit të rreziqeve dhe ndikimeve M&S duhet të jetë në përputhje me praktikën e mirë ndërkombëtare për sektorin .¹⁹

Zbatimi i këtyre kërkesave për projektin në fjalë paraqet një sfidë. Uzina e çelikut e klientit nuk është një impiant i lidhur me hidrocentralet sepse është para-ekzistuese dhe nuk po zgjerohet për shkak të blerjes së hidrocentraleve. Meqenëse hidrocentralet furnizojnë uzinën e çelikut dhe jo anasjelltas, marrëdhënia nuk përputhet me përkufizimin e IFC për rrezikun e zinxhirit të furnizimit, i cili lidhet me burimet nga merren inputet e biznesit. Si rezultat, hidrocentralet mund të shihen sikur janë pjesë e zinxhirit të furnizimit të uzinës së çelikut, por uzina e çelikut nuk është pjesë e zinxhirit të furnizimit të hidrocentraleve. Në mënyrë të ngjashme, shqetësimet në lidhje me ndikimet e uzinës së çelikut nuk mund të hyjnë lehtësisht në konceptet e ndikimeve të tërthorta apo grumbulluese të hidrocentraleve. Pyetja më e gjerë nëse objekti i procesit të IFC për identifikimin e rreziqeve dhe ndikimeve M&S ishte në përputhje me praktikën e mirë ndërkombëtare të sektorit është jashtë objektit të një vlerësimi të përputhshmërisë nga CAO.

Vlerësimi Para-Investimor dhe Mbikëqyrja e IFC Analiza dhe Diskutimi

Shqyrtimi Para-Investimor i IFC

Vlerësimi (due diligence) M&S i IFC u fokusua tek rreziqet dhe ndikimet e katër hidrocentraleve që klienti po blinte.²⁰ IFC vuri në dukje që hidrocentralet ishin në vendndodhje të ndryshme nga uzina e çelikut.²¹ IFC vërejti që klienti priste të përdorte 85 për qind të energjisë elektrike të hidrocentraleve për uzinën e tij të çelikut dhe të shiste energjinë e mbetur në treg. Si rezultat, IFC vuri në dukje që klienti nuk do të varej më nga blerja e energjisë nga kompania kombëtare e prodhimit të energjisë dhe do të ishte në gjendje të furnizonte uzinën e çelikut me energji elektrike me çmim më të ulët. Megjithatë, klienti do të vazhdonte të varej nga shpërndarësi kombëtar i energjisë për të transmetuar energjinë e prodhuar nga hidrocentralet tek uzina e çelikut.

Në fazën e hershme të procesit të vlerësimit para-investimor të IFC, ekipi i IFC ju shpreh drejtuesve që do të priste që hidrocentralet dhe uzina e çelikut të plotësonin Standardet e Performancës të IFC. Më vonë, vlerësimi dhe dokumentacioni miratues i IFC paraqesin deklaratën kundërtënëse në lidhje me objektin e projektit dhe zbatimin e kërkesave M&S të IFC: Prezantimi i investimit të IFC për Bordin e saj nuk është i prerë rreth objektit të projektit apo zbatueshmërisë së standardeve M&S të IFC për uzinën e çelikut. Një draft deklaratë për Bordin e cila përjashtonte në mënyrë të shprehur uzinën e çelikut nga objekti i projektit nuk u përfshi në raportin final për Bordin i cili kërkonte miratimin e investimit.

Si pjesë e këtij vlerësimi të përputhshmërisë, IFC informoi CAO-n që uzina e çelikut ishte jashtë objektit të projektit, dhe si rezultat, IFC nuk ka kryer vlerësim M&S të uzinës së çelikut. Megjithatë, në atë kohë, IFC vërejti raportime negative mediatike në lidhje me uzinën e çelikut dhe një çështje të procesit të CAO që ngrinte shqetësime në lidhje me ndotjen nga uzina e çelikut e klientit.²² IFC i shikoi këto akuza si rreziqe të mundshme për reputacionin. Në përgjigje të këtyre, stafi M&S i IFC kreu një vizitë në uzinën e çelikut, me përfundimin që nuk kishte defekte madhore në

¹⁹ IFC, 2012. Standardi i Performancës 1, paragrafi 7.

²⁰ IFC, 2013. *Përmbledhja e Informacionit mbi Investimin: Kurum*, e disponueshme në <https://goo.gl/qn73Qy> dhe *Përmbledhja e Shqyrtimit Mjedisor dhe Social: Kurum*, e disponueshme në <https://goo.gl/RP2Z7J>.

²¹ Hidrocentralet e Ulzës dhe Shkopetit gjenden rreth 83 km në distancë ajrore në veri të uzinës së çelikut. Bistrica I & II gjenden rreth 137 km distancë ajrore në jug të uzinës së çelikut.

²² Për më shumë hollësi shikoni rastin e CAO: Albania/Albania Hydros-01/Tirana, i disponueshëm në <https://goo.gl/pp7AKV>. Diskutime të mëtejshme rreth ndotjes në Elbasan janë të disponueshme në OBC Transeuropa. Shikoni <https://goo.gl/T4ahF1>. Në Qershor 2013, një protestë jashtë uzinës së çelikut ngriti shqetësime në lidhje me ndotjen e ajrit dhe akuzonte që klienti nuk vinte në punë filtrat e ajrit. Për më shumë detaje shikoni <https://goo.gl/KqtQm7>.

aktivitetet e tij, por që kishte mundësi të kishte shkarkime të larta përpara përmirësimeve të zbatuara në 2011-2012. IFC përfshiu katër zëra të ESAP në lidhje me uzinën e çelikut në marrëveshjen e saj ligjore me klientin. Në mënyrë specifike, IFC i kërkoi klientit (a) të përfundonte riparimin e mbulesës së repartit të shkrirjes deri në Dhjetor 2014; (b) të instalonte sistem të monitorimit të vazhdueshëm të shkarkimit të pluhurit në sistemin e filtrimit në repartin e shkrirjes deri në Qershor 2014; (c) të instalonte një alarm të mosfunksionimit të filtrave të repartit të gëlqeres në uzinën e çelikut deri në Dhjetor 2013; dhe, (d) të shqyrtonte incidentet në punë për të identifikuar drejtimet për përmirësim deri në Dhjetor 2014. Dokumentacioni i miratimit të investimit nga IFC deklaroi që zbatimi i këtyre veprimeve do të siguronte përputhjen e uzinës së çelikut me standardet e IFC dhe udhëzimet e GBB.

Marrëveshja e huadhënies së IFC kërkon që klienti të shfrytëzojë hidrocentralet në përputhje me Standardet e Performancës, por nuk përfshin kërkesa M&S për uzinën e çelikut përtej zërave të specifikuar të ESAP. Si rezultat, kërkesat e përgjithshme të IFC për kontrollin e ndotjes nuk u shtrinë tek uzina e çelikut. Në mënyrë të ngjashme, nuk u përfshi përputhja me kërkesat e IFC për angazhimin e palëve të interesuara. IFC i kërkoi klientit raportim vjetor të shkarkimeve të grimcave nga uzina e çelikut. Megjithatë, IFC nuk kërkoi raportim rreth performancës mjedisore të uzinës së çelikut për gjithë gamën e parametrave mjedisorë dhe socialë që do të pritej nëse uzina do të ishte konsideruar si pjesë e projektit.

Mbikëqyrja e IFC

IFC kreu pagesën e parë në Mars 2014. IFC kreu një vizitë mbikëqyrëse në terren në Nëntor 2014, e cila përfshiu uzinën e çelikut, dhe mori Raportin Vjetor të Monitorimit M&S (RVM) në Maj 2015.²³ Në Korrik 2015, IFC kreu një shqyrtim të përbashkët të RVM dhe raportit të mbikëqyrjes në terren. Fokusi i shqyrtimit të IFC ishte tek hidrocentralet. Në lidhje me uzinën e çelikut, IFC vuri re që klienti kishte riparuar mbulesën e repartit të shkrirjes, kishte instaluar një sistem të monitorimit të pluhurit dhe një alarm në rast mosfunksionimi të filtrave të repartit të gëlqeres. IFC gjithashtu vuri re që klienti kishte instaluar një sistem uji për të reduktuar shkarkimet e pluhurit. Në kohën vizitës së IFC, uzina e çelikut ishte në proces mirëmbajtjeje, kështu që IFC nuk kishte mundësi të vlerëonte efektivitetin e këtyre masave përmes të dhënave të monitorimit në kohë reale. Të dhënat e monitorimit tremujore të dërguara IFC në 2014 si pjesë e RVM të klientit treguan që shkarkimet e klientit ishin brenda kufijve kombëtarë, megjithatë këta kufij janë më pak të shtrënguara se kufijtë e IFC.

Në Mars 2016, Kurum Holding filloi procedurat e falimentimit.²⁴ Si rezultat, IFC nuk mori më RVM të mëtejshme nga klienti. Në Nëntor 2018, IFC kreu një vizitë mbikëqyrëse në terren, dhe arriti në përfundimin që masat e miratuara të ESAP për uzinën e çelikut ishin zbatuar. Në kohën që po shkruhej raporti, IFC nuk kishte garanci që klienti po e shfrytëzonte uzinën e çelikut në përputhje me udhëzimet e ndotjes së IFC. IFC informoi CAO se zona ku është vendosur uzina e çelikut është shpallur nga qeveria si 'Zonë e Fatkeqësisë Mjedisore'. Si rezultat, autoritetet kombëtare do të këqyrin me kujdes kontrollin e ndotjes të industrive që punojnë në zonë. IFC gjithashtu vuri në dukje që ka disa uzina industriale të tjera të cilat kanë aktivitete shumë ndotëse. Pas vizitës në terren të IFC, klienti informoi IFC që kishte instaluar një kontroll të ri të ndotjes nga pluhuri, që do të rezultonte në kursime shumë të mëdha të energjisë për aktivitetet e saj.

²⁴ IHS Global Insight, 9 Mars 2016, *Expected bankruptcy of Kùrùm International and other companies in Albania threatens banking sector and nationwide protests.*

Raportet publike

Agjencia Kombëtare e Mjedisit e Shqipërisë nxjerr një Raport Mjedisor që përmbledh treguesit mjedisorë kombëtarë. Raporti dokumenton raportet e monitorimit të ndotjes të përgatitura në sektor dhe përputhshmërinë e tyre me rregulloret kombëtare. Në lidhje me Kurum, raporti i vitit 2017 vinte në dukje që Kurum kreu monitorimin në përputhje me kushtet e lejes së tij mjedisore dhe që parametrat e matur ishin të gjithë brenda normave të lejuara.²⁵

IV. Vendimi i CAO

Qëllimi i një vlerësimi të përputhshmërisë nga CAO është të sigurojë që hetimet e përputhshmërisë të fillojnë vetëm në lidhje me projekte që ngrenë shqetësime të rëndësishme në lidhje me përfundimet M&S dhe/ose çështje me rëndësi sistematike për IFC. Për të vendosur nëse do të fillojë apo jo një hetim, CAO peshon faktorë përfshirë shkallën e M&S shqetësimeve të ngritura nga një ankesë, rezultatet e një shqyrtimi paraprak të performancës M&S të IFC në lidhje me këto çështje, dhe një vlerësim më të përgjithshëm nëse një hetim i përputhshmërisë do të ishte përgjigja e duhur.

Në këtë rast, ankuesit ngrenë shqetësimin që shkarkimet nga uzina e çelikut e Kurum kanë ndikime shëndetësore mbi ankuesit dhe familjet e tyre. Ndërkohë që ankuesit e pranojnë që kompania ka bërë përmirësime, ata perceptojnë shkarkimet nga uzina, veçanërisht natën, të jenë të dëmshme shëndetësor. Për më tepër, ata deklarojnë që informacioni rreth ndotjes nga uzina e çelikut nuk është i disponueshëm.

Një pyetje kyç për këtë vlerësim të përputhshmërisë është nëse standardet M&S të IFC duhet të ishin zbatuar për uzinën e çelikut të klientit, ndërkohë që investimi i IFC kishte për objekt blerjen e hidrocentraleve.

Në rastet kur një investim i IFC ka një përdorim të përcaktuar të të ardhurave dhe një gjurmë M&S të përcaktuar qartë, IFC mund të kufizojë zbatimin e kërkesave të saj M&S tek aktivitetet e biznesit që ka financuar. Kjo i mundëson IFC të fokusojë vlerësimin paraprak të saj (due diligence) dhe mbikëqyrjen në një aset të veçantë, nëse ai aset është ajo çfarë po financohet. Faktori që e ndërlikon këtu është se qëllimi i blerjes të hidrocentraleve ishte për të menaxhuar rrezikun e çmimit dhe furnizimit që lidhet me energjinë elektrike që i nevojitet klientit për të shfrytëzuar uzinën e prodhimit të çelikut.

Për të shmangur copëtimin e panevojshëm të aktivitetit të biznesit të një klienti në lidhje me ndikimet M&S, PS1 kërkon një vlerësim të rreziqeve dhe ndikimeve M&S në kontekstin e një fushe ndikimi të projektit, përfshirë impiantet e lidhura, ndikimet e tërthorta mbi shërbimet e ekosistemit, ndikimet që vijnë nga veprimet e palëve të treta dhe ndikimet e zinxhirit të furnizimit. Megjithatë, nuk është e qartë se si ky kuadër duhet të zbatohet për marrëdhënien ndërmjet financimit nga IFC të hidrocentraleve të klientit dhe ndikimeve të supozuara që vijnë nga uzina e prodhimit të çelikut, të cilat janë të lidhura për sa i përket procesit të biznesit të klientit, por nuk hyjnë në kategorinë e zinxhirit të furnizimit, impianti të lidhur apo ndikime të palëve të treta, siç parashikohet nga PS1.

Një analizë e dokumentacionit para-investitor M&S të IFC paraqet deklaratat kundërthënëse në lidhje me zbatimin e standardeve M&S të IFC për uzinën e çelikut. Në fazat e hershme të procesit të shqyrtimit, ekipi i IFC u tha drejtuesve që nga uzina e çelikut do të pritej që të zbatonte kërkesat M&S të IFC. Dokumentacioni i miratimit të investimit vë në dukje që masat e identifikuar për

²⁵ Agjencia Kombëtare e Mjedisit, *Raporti i Gjendjes së Mjedisit*. I disponueshëm në <https://goo.gl/4xN59W>.

kontrollin e ndotjes për uzinën e çelikut do të përmirësonin performancën e saj M&S dhe do të siguronin përputhshmërinë me standardet e IFC dhe udhëzimet e GBB. Ndërkohë që një deklaratë e qartë nga IFC që theksonte se uzina e çelikut ishte jashtë objektit të projektit ishte e përfshirë në dokumentacionin paraprak të miratimit, kjo u hoq nga versioni përfundimtar që ju paraqit Bordit të IFC.

Marrëveshja e IFC për investimin kërkon zbatimin e Standardeve të Performancës të IFC vetëm tek hidrocentralet. Marrëveshja gjithashtu kërkon që klienti të zbatojë disa masa të kontrollit të ndotjes në uzinën e çelikut dhe të raportojë çdo vit mbi shkarkimet e grimcave nga uzina e çelikut. Gjatë procesit të këtij vlerësimi, IFC informoi CAO që këto ishin përfshirë pas një vlerësimi të shpejtë të uzinës së çelikut për shkak të rreziqeve të reputacionit që lidhen me performancën së saj mjedisore.

Në rastet kur IFC negocion zëra shtesë të planit të veprimit M&S për të përmirësuar performancën M&S të aktiviteteve të biznesit të një klienti, të cilat nuk kanë lidhje me aktivitetet e biznesit që IFC po financon, IFC shkon përtej kërkesave të Politikës së Qëndrueshmërisë. Megjithatë, në këtë rast, hidrocentralet dhe uzina e çelikut të financuara nga IFC janë të lidhura meqenëse të parat japin inpute të energjisë elektrike për të dytën. Duke marrë parasysh mungesën e qartësisë rreth zbatueshmërisë të standardeve M&S të IFC në lidhje me këtë strukturë projekti dhe mungesën e qartësisë në dokumentacionin e IFC për këtë çështje, CAO ka shqetësimin që vendimi i IFC për të investuar është bërë pa një paraqitje të plotë të kuadrit të zbutjes së rreziqeve për projektin.

Pas lëvrimit të huasë së IFC, IFC ka mbikëqyrur zbatimin e zërave ESAP të miratuar që lidhen me uzinën e çelikut. Në Nëntor 2014, IFC konfirmoi që klienti kishte: (a) riparuar mbulesën e uzinës së çelikut; (b) instaluar një sistem të monitorimit të vazhdueshëm të shkarkimit të pluhurit në sistemin e filtrimit në repartin e shkrijës; dhe (c) instaluar një alarm të mosfunksionimit të filtrave të repartit të gëlqeres në uzinën e çelikut. Megjithatë, meqenëse uzina nuk punonte në kohën e vizitës së IFC, IFC nuk ishte në gjendje të shqyrtonte efektivitetin e këtyre ndërhyrjeve si masa të kontrollit të ndotjes. Menjëherë pas kësaj kohe, klienti filloi procedurat e falimentimit. Gjatë kësaj periudhe, IFC nuk mori raportime të M&S nga klienti. Në Nëntor 2018, gjatë një vizite në terren, IFC konfirmoi përsëri që zërat e ESAP ishin zbatuar në uzinën e çelikut, megjithatë, dokumentacioni i mbikëqyrjes i IFC nuk ofron siguri që uzina e çelikut e klientit plotëson standardet e IFC për kontrollin e ndotjes, angazhimin e palëve të interesuara apo trajtimin e ankesave.

IFC i është shprehur CAO se, ndërkohë që nuk e konsideron uzinën e çelikut si pjesë e fushës së veprimit të projektit, mbikëqyrja e vazhdueshme e klientit nga IFC do të monitorojë efektivitetin e zbatimit të masave të kontrollit të ndotjes në uzinën e çelikut për të siguruar përputhje me standardet e IFC dhe udhëzimet e Bankës Botërore. Kjo do të bazohet në dëshirën e mirë të klientit meqenëse as standardet e IFC apo kërkesat standarde të raportimit M&S nuk ishin bërë pjesë e marrëveshjes së huasë për uzinën e çelikut. Për më tepër, IFC ju zotua CAO që do të punojë me klientin e saj për ta inkurajuar të publikonte rregullisht të dhënat e shkarkimeve ndotëse tek komunitetet lokale pranë uzinës së çelikut.

Duke marrë parasysh masat e marra nga IFC dhe klienti i saj për të zbutur ndikimet negative të ndotjes të uzinës së çelikut të klientit, dhe mungesën e qartësisë mbi zbatimin e standardeve M&S të IFC në aktivitetet e klientit për prodhimin e çelikut, CAO arrin në përfundimin që një hetim mbi përputhshmërinë nuk është përgjigja e duhur për këtë ankesë. Si rezultat, ankesa mbyllet.